

FJALA E DEPUTETES ERALDA BANO

E ENJTE 20 TETOR 2022

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Në fakt, unë sot ndihem realisht e emocionuar, sepse ne e kemi pritur shumë gjatë këtë ditë, me thënë të drejtën, 32 vjet. Sot Shqipëria është një nga të paktat vende ish-komuniste, që nuk ka bërë pothuajse asgjë për krimet e regjimit diktatorial, ku numërohen mbi 7 mijë viktima dhe dhjetëra të tjerë që kanë vuajtur.

Dita e Përkujtimit të Viktimave të Regjimit Komunist, 20 shkurti, kaloi sërish në heshtje nga qeveria dhe të përndjekur politikë janë ende të padëmshpërblyer.

Gjatë diktaturës komuniste u vranë rreth 6800 persona, 1 mijë humbën jetën në burgje, ndërsa rreth 6 mijë të tjerë vdiqën nga kushtet e kampeve të internimit.

Në total janë kryer rreth 1 milion vite burg nga 34 mijë të burgosur politikë, të paktën 59 mijë qytetarë u internuan dhe bënë punë të detyruar për ngritjen e infrastrukturave të vendit dhe në bujqësi.

Në total kanë qenë 100 burgje, kampe me tela me gjemba, kampe internimi, kampe pune të detyruar.

Pavarësisht kësaj dhune, askush nuk mbajti përgjegjësi, madje Shqipëria nuk aplikoi dot me sukses një ligj lustracioni, që do të thotë se ish-komunistët dhe bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit nuk u përjashtuan nga pushteti. Nga ana tjetër, të përndjekurit nuk u integruan dhe nuk u dëmshpërblyen edhe pas 30 vjetëve.

Shqipëria është nga të paktat vende ish-komuniste që nuk ka bërë pothuajse asgjë për krimet e regjimit diktatorial, për rrjedhojë mbetemi peng i bijve të atyre që shkatërruan mijëra jetë nga marrëzia e një diktatori, që edhe sot i ka rrënjët e tij në pushtet.

Sot do të kërkoj drejtësi për gjithë ata njerëz që humbën jetën e tyre nga horrori enverian. Sot do të ngre zërin në nder të gjyshërve të mi, të cilëve iu shkul çdo fije dinjiteti dhe shprese.

Mirënjohje të thellë për ata njerëz që kanë vuajtur dramën e regjimit komunist! Mirënjohje për ata njerëz që mbajtën gjallë shpresën dhe besimin e tyre dhe rezistuan, pavarësisht terrorit!

Të gjithë ata që nuk do të kenë guximin të votojnë këtë ligj sot, duke nxjerrë ndoshta edhe arsye objektive, kanë detyrimin moral që nesër të publikojnë dosjet e tyre dhe le të na gjykojnë shqiptarët.

Rroftë demokracia e vërtetë dhe, nëse jo, ligji. Zoti i dënoftë kriminelët! Faleminderit!